



## VENDIM

Nr. 41 Datë 07.04.2015

### PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E LIÇENSËS SË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “EURON  
ENERGY GROUP” SH.P.K. , MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT  
TË KOMISIONERVE TË ERE-S NR.87, DATË 26.09.2011, TEK  
SHOQËRITË “ALB-ENERGY” SH.P.K, “EURON ENERGY” SH.P.K.  
DHE “ENERGAL” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 20, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 7, neni 149 të ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar; si dhe nenit 4, nenit 17 pika 1, pika 3, 4 dhe pika 5, të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të Liçensave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 07.04.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë **“EURON ENERGY GROUP”** sh.p.k., liçensuar në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike me Vendimin nr.87 datë 26.09.2011 të Bordit të Komisionerve të ERE-s për miratimin e transferimit të liçensës së prodhimit dhe të tregëtimit të energjisë elektrike të shoqërisë **“EURON ENERGY GROUP”** sh.p.k tek shoqëritë **“ALB-ENERGY”** sh.p.k, **“EURON ENERGY”** sh.p.k dhe **“ENERGAL”** sh.p.k si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

### Konstatohet se :

Nga dokumentacioni i paraqitur në ERE nga shoqëritë **“EURON ENERGY GROUP”** sh.p.k., **“ALB-ENERGY”** sh.p.k., **“EURON ENERGY”** sh.p.k. dhe **“ENERGAL”** sh.p.k., sipas nenit 17 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/te Pjesshem dhe Rinovimit te Liçensave”, rezultojnë:

*Shoqëria “EURON ENERGY GROUP ” sh.p.k.,*

Neni 17, pika 4 germa a : Formati i aplikimit sipas neni 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Informacioni, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licenses I plotësuar në mënyrë korrekte; germa c: Vendimin me shkrim në organet drejtuese të të licensuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licenses, plotësuar në mënyrë korrekte.

*Shoqëria “ALB-ENERGY ” sh.p.k.,*

Neni 17, pika 2 germa a : Formati i aplikimit sipas neni 9, pika 1, plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Dokumentat juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa c: Dokumentat financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (Shoqëria “ALB-ENERGY ” sh.p.k., është shoqëri e sapo krijuar); germa d: I plotësuar në mënyrë korrekte.

*Shoqëria “EURON ENERGY ” sh.p.k.,*

Neni 17, pika 2 germa a : Formati i aplikimit sipas neni 9, pika 1 plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Dokumentat juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa c: Dokumentat financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (Shoqëria “EURON ENERGY ” sh.p.k., është shoqëri e sapo krijuar); germa d: I plotësuar në mënyrë korrekte.

*Shoqëria “ENERGAL ” sh.p.k.,*

Neni 17, pika 2germa a : Formati i aplikimit sipas neni 9, pika 1 plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Dokumentat juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa c: Dokumentat financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (Shoqëria “ENERGAL” sh.p.k., është shoqëri e sapo krijuar); germa d: plotësuar në mënyrë korrekte.

Meqenese liçensa e tregtimit nuk mund të transferohet njëkohesisht në tre subjekte të ndryshëm, do të komunikohet me shoqërite e mësipërme që liçenca e shoqërisë “EURON ENERGY GROUP” SH.P.K t’i transferohet vetem njerit nga subjektet, apo secili nga subjektet “ALB-ENERGY” sh.p.k., “EURON ENERGY” sh.p.k. dhe “ENERGAL” sh.p.k. që do të aplikojë në ERE për pajisjen me liçensë tregtimi.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1 - Fillimin e procedurave për transferimin e licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë “EURON ENERGY GROUP”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr.87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “ALB-ENERGY” sh.p.k.

2 - Fillimin e procedurave për transferimin e licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë “EURON ENERGY GROUP”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr.87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “EURON ENERGY” sh.p.k..

3 - Fillimin e procedurave për transferimin e licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë “EURON ENERGY GROUP”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr.87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “ENERGAL” sh.p.k.

4-Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “EURON ENERGY GROUP“ sh.p.k, “ALB-ENERGY” sh.p.k, “EURON ENERGY“ dhe “ENERGAL“ sh.p.k. për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**